

AKTI I THEMELIMIT

PËR SHOQËRINË "ISEL CONSTRUCTION" SHPK

FORMIMI I SHOQËRISË

Sot në Tiranë në datën 13 Tetor 2021 themelohet shoqëria tregtare me përgjegjësi të kufizuar e emërtuar "ISEL CONSTRUCTION" shpk, me vullnetin e lirë të ortakëve:

1.Marsel Telha, shtetas Shqipëtar, i biri i Selmanitt, i datëlindjes 23.03.1983 lindur në Korce dhe banues në **Tiranë,Rruga Ramazan Gaxheri, Fresku** madhor e me zotësi të plotë për të vepruar pa pengesa ligjore, me nr pashaporte I30323041K.

2.Erald Basho, i biri i Nebiut shtetas Shqipëtar,i datëlindjes 26.02.1990 lindur në Skrapar dhe banues në **Kombinat, Rruga Llambi Bonata**, madhor dhe me zotësi të plotë për të vepruar pa pengesa ligjore, me nr pashaporte J00226091J.

SELIA E SHOQERISE

1.Shoqëria tregëtare " ISEL CONSTRUCTION " SHPK., ka selinë qendrore në territorin e **Republikës së Shqipërisë në qytetin e Tirane, TIRANE Njesia Bashkiake Nr 11, Rruga Gjergj Legisi, Godine dy kateshe, Nr3** me vendim të ortakëve të shoqërisë , mund të ngrihen edhe filiale, degë apo dhe seli përfaqësimi në vende të tjera brenda dhe jashtë Shqipërisë.

2.

KOHËZGJATJA E SHOQËRISË

1. Shoqëria Tregtare "ISEL CONSTRUCTION" SHPK., do të përmbushë objektin e veprimtarisë së saj me një afat të pacaktuar.
2. Ndryshimet e shoqërisë duke përfshirë edhe përcaktime të mëvonshme në lidhje me kohëzgjatjen e aktivitetit të saj nuk sjellin si pasojë krijimin e një Personaliteti të ri Juridik.

KAPITALI I SHOQËRISË

Kapitali themeltar i shoqërisë përbëhet nga 100,000 lekë (Njqind mije leke) , i cili është tërësisht kapital financiar . Kapitali themeltar është i ndarë në 2 (dy) kuota, ku njera kategori me vlerë nominale 60,000 lekë (gjashtedhjetë mije leke) dhe kuota tjetër 40,000 (dyzet mije leke).

Kapitali themeltar zotërohet nga:

1.Marsel Telha, zotërues i 1 (një) kuote apo 40 % të kapitalit të shoqërisë.

Ortaket kanë të drejtë të tjetërsojnë, të zmadhojnë apo të pakësojnë kuotat e kapitalit deri në kufinj të përcaktuara nga ligji.

2.Erald Basho, zotërues i 1 (një) kuote apo 60 % të kapitalit të shoqërisë.

Ortaket kane të drejtë të tjetërsojnë, të zmadhojnë apo të pakësojnë kuotat e kapitalit deri në kufinj të përcaktuara nga ligji.

OBJEKTI I VEPRIMTARISË:

Objekti i veprimtarisë së shoqërisë “ISEL CONSTRUCTION” shpk do të jetë :

Aktiviteti i shoqërisë do të konsistoje në ofrimin e shërbimeve në fushën e ndërtimit si: Shërbime hidraulike, elektrike, gipsi, partinim lysterje, si dhe shërbime në fushën e arredimit mobilimit, përpunim dhe shitje lende druri, si dhe aktivitete dhe shërbime të cilat lidhen me fushën e ndërtimit. Kryerja e çdo aktiviteti dhe operacioni ekonomik dhe juridik, prodhues dhe tregtar dhe financiar, që lidhet drejtëpërdrejt ose tërthorazi me objektin e veprimtarisë së shoqërisë, për të cilin, në bazë të legjislacionit shqiptar kërkohet leje dhe posaçërisht nga organet kompetente të administratës publike do të realizohet pasi të jete siguruar leja përkatëse. Kjo përfshin hapjen e veprimtarive të reja, krijimin e sipërmarrjeve të tjera si dhe pjesëmarrjen në sipërmarrje të tjera si brenda dhe jashtë vendit. Objekti i veprimtarisë së shoqërisë mund të ndryshohet ose shtohet me vendimin e të dy ortakëve. Shoqëria mund të kryejë çdo operacion tregtar, të blejë, të shesë ose të marrë me qera ndërmarrje, si dhe të ketë interesa ose pjesëmarrje në shoqëri, ente, konsorciume të themeluara apo në themelimin e sipër që kanë objekt të njëjtit ose të ngjashëm me të vetin apo gjithësisht funksional për arritjen e qëllimeve të shoqërisë. Shoqëria mund të kryejë çdo aktivitet tjetër të nevojshëm apo të dobishëm për realizimin e qëllimeve të shoqërisë. Dhenie me qera të ambienteve dhe paisjeve industriale.

Me zgjerimin e aktivitetit shoqëria mund të bëjë shtesa të ndryshme ose ndryshime të objektit të veprimtarisë së saj duke bërë ndryshimet përkatëse në statut.

ORGANET DREJTUESE TË SHOQËRISË

1. Organi drejtues i shoqërisë është asambleja e përgjithshme e ortakëve e cila është përgjegjëse për marrjen e vendimeve për çështje të mëposhtme :

- a- për ndryshime në statut
- b- emërimin dhe shkarkimin e administratorit
- c- miratimin e bilancit dhe të pasqyrave financiare vjetore.
- d- zmadhimin dhe zvogëlimin e kapitalit
- e- riorganizimin dhe prishjen e shoqërisë.

2. Administratori i përgjithshëm i shoqërisë, është **Marsel Telha** me afat 5 vjeçar me të drejtë ripërtëritje.

BAZA LIGJORE

E gjithë veprimtaria e shoqërisë do të bazohet në ligjin 9901 datë 14.04.2008” Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare “ si dhe në legjislacionin në përgjithësi të Republikës së Shqipërisë.

Ky Akt Themelimi u nënshkrua në tre kopje të barasvlefshme të tij. Njëri prej tyre ruhet në selinë e shoqërisë.

ORTAKET:

Marsel Telha

Marsel Telha



Faqja 2 nga 2

Erald Basho

Erald BASHO

